



**Republika e Kosovës**  
Republika e Kosovës – Republic of Kosovo  
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova




**QENDRA E STUDENTËVE  
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS  
PRISHTINË**

**STUDENTS' CENTER OF  
UNIVERSITY OF PRISHTINA  
PRISHTINA**

**STUDENTSKI CENTAR  
UNIVERSITETA PRISHTINE  
PRISHTINA**

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë



Në bazë të nenit 9 dhe 13, të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë të datës 05.05.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve të Prishtinës në Prishtinë, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR RENDIN SHTËPIAK TË QENDRËS SË STUDENTËVE NË PRISHTINË**

### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet rendi shtëpiak në Qendrën e Studentëve në Prishtinë.

### **Neni 2**

Dyert e hyrjes në konvikt janë të hapura nga ora 05:00 deri në 24:00.

Studenti banues në konvikt mund të kthehet edhe pas orës 24:00 vetëm me leje të veçantë me shkrim nga Udhëheqësi i konviktit.

Orari mund të ndryshohet me vendim të posaçëm të Drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Studentëve.

### **Neni 3**

Hyrja në konvikt është e lejuar edhe pas kësaj kohe në rastet kur organizohen:

- Mbrëmje të absolventëve.
- Mbrëmje të brucoshëve.
- Mbrëmje shoqërore.
- Aktivitete arsimore, kulturore e artistike (ligjërata publike, koncerte, shfaqje teatrale, etj.).

Për rastet e mësipërme është e nevojshme që paraprakisht të sigurohet pëlqimi i udhëheqësit të konviktit. Me këtë rast, organizatori i cili e kërkon lejen, personi zyrtar duhet t'i dorëzojë regjistrin e studentëve banues në konvikt, bashkë me numrin e dhomës dhe numrin e lejes për hyrje në konvikt. Një kopje e regjistrit bashkë me leje duhet të dorëzohet në reception.

### **Neni 4**



Lejohen vizitat e palëve të së njëjtës gjini nga konviktet e Qendrës së Studentëve prej orës 10:00 deri në orën 17:00, çdo ditë të javës.

Në konviktet e meshkujve vizitat e studentëve banues lejohen nga ora 10:00 deri në 17:00. Studenteve bauese femra u lejohet të hyjnë në konviktet e meshkujve pasi të jetë evidentuar në fletoren e vizitave dhe ndaljes së dokumentit.

Në konviktet e femrave, vizitat lejohen vetëm për prindërit.

Lejohen vizitat e anëtarëve të familjes së ngushtë çdo ditë të javës prej orës 08:00 deri në orën 17:00.

Palët duhet të posedojnë me vete dokumentin zyrtar që dëshmon afërsinë familjare ndërmjet personit që vizitohet dhe vizitorit dhe evidentohet në fletorën e vizitave.

#### **Neni 5**

Punëtori në recepcion është i obliguar të respektojë me përpikëri kërkesën e studentit, në rast se nuk bie ndesh me nenet e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 6**

Furnizimi me ujë në lokalet e përbashkëta është i përditshëm. Reduktimi i orarit të furnizimit me ujë nga ana e punonjësve të Qendrës nuk guxon të bëhet. Kufizimet e pjesëshme mund të bëhen vetëm në rastet urgjente, me qëllim të parandalimit të dëmeve materiale.

Qendra nuk është përgjegjëse për kufizimet që sipas planit i ndërmerr Drejtoria e sistemit të ujësjellësit "Batllava" në Prishtinë.

#### **Neni 7**

Orari i furnizimit me ujë të ngrohtë duhet të përpilohet në fillim të sezonit dhe mund të ndërrohet brenda po atij sezoni.

Reduktimi i orarit të furnizimit me ujë të ngrohtë nuk guxon të bëhet. Kufizimet e pjesëshme mund të bëhen vetëm në raste urgjente, me qëllim të parandalimit të dëmeve materiale.

#### **Neni 8**

Furnizimi me ngrohje bëhet sipas orarit të shfrytëzimit që përcakton OP, "Termokos", në Prishtinë. Në rast të ngrohjes jo cilësore, Qendra siguron ngrohje cilësore me shtimin e temperaturës së ujit të nxehtë nga kaldajat e saj. Temperatura në dhomat e studentëve gjatë sezonit të ngrohjes nuk guxon të jetë nën optimalin që parashihet me ligjin përkatës.

#### **Neni 9**

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës në rast të alarmit për rrezik nga zjarri apo rrezik nga fatkeqësitë tjera elementare (tërmeti, shembje e objektit etj.), do të udhëzohen menjëherë nga personat e autorizuar për veprimet që ata duhet t'i ndërmarrin.

#### **Neni 10**

##### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për rendin shtëpiak të Qendrës së Studentëve në Prishtinë, nr.113 të datës 29.03.2017

#### **Neni 11**



## Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.

Prishtinë

29.12.2022



Drejtori i Përgjithshëm  
Fatmir Sfishta

*[Handwritten signature of Fatmir Sfishta]*

